

VENDIM
Nr. 848, datë 24.12.2019

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE ME SHKËMBIM LETRASH
TË MARRËVESHJES SË GRANTIT NR. TF013972, NDËRMJET REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE
ZHVILLIM/SHOQATËS NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM, QË VEPRON SI
ADMINISTRATORE E FONDEVE GRANT TË SIGURUARA NGA DHURUES TË
NDRYSHËM, NËN FONDIN E DYTË TË BESIMIT SHUMËDHURUES PËR
SHQIPËRINË, PËR MBËSHTETJEN PËR NGRITJEN E KAPACITETEVE PËR
ZBATIMIN E SISTEMIT TË PLANIFIKIMIT TË INTEGRUAR (SPI) 2,
MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 243, DATË 3.4.2013, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 12, 19 e 23, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndryshuese, me shkëmbim letrash, të marrëveshjes së grantit nr. TF013972, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim/Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim, që vepron si administratore e fondeve grant të siguruar nga dhurues të ndryshëm, nën Fondin e Dytë të Besimit Shumëdhurues për Shqipërinë, për mbështetjen për ngritjen e kapaciteteve për zbatimin e Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI) 2, miratuar me vendimin nr. 243, datë 3.4.2013, të Këshillit të Ministrave, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

BANKA BOTËRORE
BNRZH-IDA GRUPI I BANKËS BOTËRORE

WORLD BANK GROUP OFFICE
PRASTERSTRASSE 31/21
Vienna, Austria, 1020

LINDA VAN GELDER
Drejtoresh Rajonale, Ballkani Perëndimor
Rajoni i Evropës dhe Azisë Qendrore

27 qershor 2019

Shkëlqesisë së saj, Anila Denaj
Ministër
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3
Tiranë,
Shqipëri

E nderuar znj. Ministre,

Shqipëri: Mbështetje për ngritjen e kapaciteteve për zbatimin e sistemit të planifikimit të integruar (SPI) 2

Granti nr. TF013972 dhe granti nr. TF0A8666

Ndryshimi i marrëveshjes së grantit dhe letërmarrëveshjes

I referohemi marrëveshjes së grantit (TF013972), të datës 7 mars 2013, ndërmjet Republikës së Shqipërisë (“Marrësi”) dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim/Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (“Banka Botërore”), e ndryshuar; dhe letërmarrëveshjes (TF0A8666), të datës 30 tetor 2018, ndërmjet marrësit dhe Bankës Botërore, që vepron si administratore e fondeve të grantit të siguruar nga dhurues të ndryshëm (Dhurues) nën Fondin e Besimit Shumëdhurues për mbështetje në ngritjen e kapaciteteve për zbatimin e Sistemit të Planifikimit të Integruar 2 (SPI) 2. I referohemi dhe shkresës suaj me nr. prot. 3423/3, e datës 9 prill 2019, ku i kërkon Bankës Botërore të shtyjë datën e disbursimit të fondeve për grantet e përmendura më sipër, sipas marrëveshjes së grantit dhe letërmarrëveshjes përkatëse.

Kemi kënaqësinë t’ju informojmë se Banka Botërore pajtohet me kërkesën tuaj dhe për këtë arsye ka vendosur 30 qershorin 2020, si datën e fundit për qëllimet e seksionit 3.03, të aneksit të marrëveshjes së grantit dhe letërmarrëveshjes përkatëse.

Të gjithë termat dhe kushtet e tjerë të të dyja marrëveshjeve, me përjashtim sa është ndryshuar këtu, mbeten në fuqi dhe në efekt të plotë.

Sinqerisht,

(nënshkrimi)

Linda Van Gelder

Drejtoresha Rajonale, Ballkani Perëndimor
Rajoni i Evropës dhe Azisë Qendrore

cc: Z. Patrizio Pagano, Drejtor Ekzekutiv, Banka Botërore

Tel.: +43 (1) 2170 782 Faks: +43 (1) 2170 701